

VENDIM
Nr.610, datë 11.9.2003

**PËR FINANCIMIN E PROGRAMEVE KOMBËTARE TË KËRKIMIT DHE TË
ZHVILLIMIT PËR VITIN 2003**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.7893, datë 22.12.1994 "Për shkencën dhe zhvillimin teknologjik", i ndryshuar, të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Fondi prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh, miratuar në buxhetin e vitit 2003 për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, për programet kombëtare të kërkimit dhe të zhvillimit, të shpërndahet si më poshtë vijon:

Nr.	Programi	Fondi (milionë lekë)	Ministria/Institucioni përgjegjës
1	Shkencat humane dhe albanologjike	7.0	Akademia e Shkencave
2	Sistemet dhe teknologjitë e informacionit	10.0	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
3	Bioteknologjitë dhe diversiteti biologjik	9.0	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
4	Bujqësia dhe ushqimi	7.0	Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit
5	Shëndetësia	6.0	Ministria e Shëndetësisë
6	Pasuritë natyrore	8.0	Akademia e Shkencave
7	Fond rezervë për hartimin e programeve të reja	3.0	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
	Totali	50.0	

Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano